



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:195157

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06383129

**C.nr.455/22**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, në çështjen juridike të paditësve V.B.I.G.L.K.N.K.B.B.K., që të gjithë të punësuar në SHFMU “Tafil Kelmendi” në fshatin B. Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Bestar Kolgeci nga Prizreni, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, jashtë seancës gjyqësore, me datën 31.10.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve V.B.I.G.L.K.N.K.B.B.K., që të gjithë të punësuar në SHFMU “Tafil Kelmendi” në fshatin B. Komuna e Malishevës, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t`ua paguaj paditësve në vijim:

- Paditëses **V.B.** për 185 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**,
- Paditësit **I.G.** për 185 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**,
- Paditësit **L.K.** për 185 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**.
- Paditësit **N.K.** për 185 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**

- Paditëses **B.K.B.** për 185 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**

Të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 19.07.2022, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 290.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit..

### **A r s y e t i m**

Paditësit V.B.I.G.L.K.N.K.B.B.K., që të gjithë të punësuar në SHFMU “Tafil Kelmendi” në fshatin B. Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të tyre Av. Bestar Kolgeci, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësit janë të punësuar tek e paditura, paditësve u takon ushqimi ditor në vlerë prej 2 euro në ditë të punës, e paditura nuk e ka përmbushur vullnetarisht kërkesën e paditësve, siq parashihet me nenin 35 par.7 i Kontrates Kolektive, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi padia e paditësve si e bazuar dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar padinë e paditësit, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me dt; 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu, MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me dt: 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, meqenëse kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qen e lidhur nga kjo ministri komuna e Malishevës - DKAE lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet te palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT, poashtu sipas përgjigjës në padi, e paditura ka theksuar se borxhi është parashkruar, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin V.B.kërkesën drejtuar

Drejtoris Komuna te Arsimit në Malishevë, dhe vërtetimin 30-2021 e datës 20.01.2021, për paditësin I.G.kërkesën drejtuar Drejtoris Komuna te Arsimit në Malishevë, dhe vërtetimin 30-2021 e datës 20.01.2021, për paditësin L.K.kërkesën drejtuar Drejtoris Komuna te Arsimit në Malishevë, dhe vërtetimin 30-2021 e datës 20.01.2021, për paditësin N.Kkërkesën drejtuar Drejtoris Komuna te Arsimit në Malishevë, dhe vërtetimin 30-2021 e datës 20.01.2021, për paditësin B.B.K.kërkesën drejtuar Drejtoris Komuna te Arsimit në Malishevë, dhe vërtetimin 30-2021 e datës 20.01.2021.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, po ashtu nuk është kontestuese edhe drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, kjo gjykatë vlerëson se paditëseve i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’u aprovojë sipas periudhës të vitit 2021 dhe 2022 gjatë të cilës paditësit kanë punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetuan edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e

paditëses sa i përket kompensimit për shujtë ditore, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”* e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit të shujtave . Andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadsisë së paditësve.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me atë se padia është paraqitur për periudhën sa nuk kishte kontrat kolektive, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësit padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, si dhe pretendimi i të paditurës se kemi të bëjmë me parashkrim nuk qëndron pasi që me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”* e që padia është parashtruar me dt.19.07.2022, pra brenda afatit ligjor prej 3 vitesh.

Pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padsisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për vitin 2020 (01.01.2020-31.12.2020) sipas vërtetimeve të lartcekura të gjithë paditësit kanë nga 185 ditë pune, andaj (185 x 2=370) të njëjtëve iu takojnë nga 370 euro secilit prej tyre, në emër të shujtave ditore. Në rastin konkret gjykata gjeti se e

paditura ka pasur për detyrim që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e ushqimit për punë në shumën e përgjithshme prej 370.00 euro secilit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (19.07.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësve t'ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 260.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro, sipas Rregullores për tarifa të avokatëve.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës e në lidhje më dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË**

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.455/22 me datën 31.10.2024

Gj y q t a r j a  
Hatixhe Begaj

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.